



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA PERMET

[Email. [info@bashkiapermet.gov.al](mailto:info@bashkiapermet.gov.al) ]

[Website: [bashkiapermet.gov.al](http://bashkiapermet.gov.al)]

## DETYRË -PROJEKTIMI

**OBJEKTI: MBROJTJA NGA UJRAT E LARTA TË KANALIT: “PËRROI I BARDHË”  
QYTETI PËRMET**

Vëndndodhja e objektit : Mbi Lagjen e vjeter historike, Qyteti Përmet.

ZYRA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

MIRATOHET  
KRYETARI I BASHKISE  
Alma HOXHA

PËRMET

## Te pergjithshme

---

### Gjendja e objektit dhe vlerësimi i situatës aktuale.

#### **Historiku i kanalit Perroi i Bardhe:**

*Perroi i bardhe ka shkatuar disa here permbytje ne qytetin e Permetit. Keshtu jane rregjistruar permbytje në vitet 1933, 1935, 1938 -1962, ku përveç dëmeve materiale ka shkaktuar dhe 28 viktime. Mbas permbytjes ne vitin 1962 , pushteti lokal dhe ai qendror ne ate kohe mori disa masa per mbrojtjen e ujrave te larta duke realizuar disa "prita" (3 te tilla) me mure gabion si dhe shtresa betoni me qellim uljen e energjise se levizjes se ujrave e inerteve qe sjell ky perrua te cilat vijene nga dy degezime kryesore rrjedhjesh nga mali Dhembel, si dhe ndertimin me beton seksion tip ne nje gjatesi rreth 600 m ne zonen e lagjes teqe. Pritat dhe shtresa e betonit aktualisht jane teresisht te shkaterruara, ndersa kanali me beton me seksion tip ne nje gjatesi rreth 600 ml eshte ne gjendje te rregullt I cili eshte rehabilituar kohet e fundit. Por ky kanal nuk vazhdon me poshte drejt qytetit modern. Gjatesia epa realizuar me kanal betoni eshte rreth 800 ml, dhe aktualisht aty ka zhvilim te bimesise ne menyre te pakontrolluar si dhe gerryerjet dhe erozioni gjithashtu jane te pa kontrolluara.*

#### **Vlerësimi i situatës aktuale:**

Në vlerësimin e sfidave me të cilat përballet Qyteti i Përmetit sot, është e vështirë të shmangësh përshtypjen e qartë të një komponenti jashtëzakonisht të brishtë, relativisht periferik të qytetit, subjekt i një procesi transformimi dhe humbjeje graduale e cila prek dhe peisazhin e "Përroit të Bardhë"..

Skarpatat e këtij perroi janë subjekt i erozionit dhe argjinatura origjinale është aktualisht jashtë funksionit. Struktura e skarpatave të kanalit, **e bërë me beton**, është përkeqësuar dhe bimësia, që ka zgjeruar çarjet në beton. Kjo gjendje e degraduar mund të ndikojë në permbytjet e zonës përrreth kanalit.

Një studim i plotë dhe një projekt gjithëpërfshirës është një domosdoshmëri për kanalin "Përroi i Bardhë", ndërhyrja në këtë segment përfundimisht do të përmirësojë tërë paraqitjen urbane

Argjinatura perëndimore përdoret **si një shteg natyrore** që lidh qytetin e Përmetit me shtigjet natyrore të malit Dhëmbel, më saktësisht shtigjet: Përmet - Lipë --Leusë dhe Përmet - Sheper.

Pjesa e sipërme e Argjinaturës Lindore që është e mbuluar me një zabel pishash ka fragmente të ndryshme që kërkojnë përforcime, për të përmbytur terrenin. Argjinali është i okupuar nga bimësia që rritet në mënyrë të pakontrollueshme, por pishat krijojnë një atmosferë piktoreske që është një vlerë e shtuar për qendrën historike.

Përroi i kanalizuar, që mbledh përrenj të tjerë që burojnë nga mali Dhëmbel, është një perrua sezonal. Gjatë pjesës kryesore të vitit, kanali është pa ujë, por në sezone rreshjesh mund të bëhet i paparashikueshëm, Rreziku i permbytjeve është në kontroll nga diga e ndërtuar në pjesën perëndimore - në rrjedhën e sipërme.

#### **Qellimi i projektit.**

##### *Nderhyrjet e domosdoshme.*

Me qellim evitimin e permbytjeve te qytetit te Permetit nga prurjet e larta te perroit te bardhe eshte e nevojeshme nderhyrja ne infrastrukturen e ketij kanali. Infrastruktura e qytetit te Permetit sidomos zona e lagjes historike ne mes te se ciles kalon ku perrua kane pesuar zhvillime ku pergjate ketij perroi ka ndertime private dhe ne rast te daljes se ketij perroi keto objekte jane me rrisht shume te larte te permbytjeve.

## Detyrat qe duhet te zgjidhe projekti.

Nderhyrjet jane te domosdoshme dhe duhet te konsistojne ne :

- 1- **Ndertimi i pritave** (zona-1) me qellim depozitimin e materialeve inerte qe vijne nga prurjet me nje gjatesi rreth 500 ml. Duke patur parasysh ndertimin ekzistues te ketyre pritave (tashme te shkaterruara) duhen 3 te tilla duke u ndertuar me mur gabion ne drejtimin terthor te kanalit, po ashtu edhe ne mure gabioni ne faqet anesore te kanalit me qellim evitimin e gerryerjeve nga ujrat. Terreni me nje disnivel te madh e ben te nevojeshme ndertimin e tyre per te shuar energjine qe krijohet si rezultat i pjerresise se madhe.
- 2- **Shtrese betoni mbi keto prita** me qellim uljen e energjise levizese te ujrave ne rast te prurjeve te medha. Keto shtresa do te realizonin levizjen e ujit ne menyre te kontrolluar mbasi depozitimi i inerteve eshte bere ne “prita”
- 3- **Vazhdimin e ndertimit te seksionit tip te kanalit** (zona-3) deri ne daljen ne lumin Vjose. *Seksioni tip i kanalit ekzistues eshte funksional ne nje gjatesi rreth 600 ml.* Vazhdimi i ndertimit te kanalit sipas ketij seksioni me nje gjatesi rreth 800 ml kalon ne pjesen me te ndertuar nga ana e ndertimeve private. Ky kanal mund te realizohet sipas kanalit tip ekzistuespor mund te jete i mbuluar duke realizuar mbi te elemente te mobilimit urban si rruge-lulishte etj.
- 4- **Preventivi i punimeve** te behet me çmimet manuale ne fuqi dhe duke u shoqeruar me analizat per zerat e punimeve qe nuk jane parashikuar ne manualet e miratuara.

### *Standarte në Projektim*

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjate zbatimit. Eshtë përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi të gjitha standarteve dhe normave përkatëse. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Detajet teknike të infrastruktures për kete kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të projektit. Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

## Realizimi i projektit dhe dokumentacioni i nevojshem.

Fazat e projektimit për këtë objekt sipas VENDIM “Nr. 408, datë 13.5.2015 Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, VKM nr. 354 datë 11.05.2016 janë:

- Analiza e Detyrës së Projektimit/Terma Reference dhe përcaktimi bazës së projektit.
- Projekt Idea Përfundimtare
- Projekti për miratimin e Lejës së Ndërtimit
- Projekti i plotë arkitektonik dhe relacioni shoqërues i tij, të nënshkruar elektronikisht nga projektuesi në format pdf dhe dwg;
- Grafiku i punimeve.
- Relacion teknik i projektuesit.

- Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;
- Grafiku paraprak i punimeve dhe afati i përfundimit të punimeve, sipas fazave të zbatimit;
- Deklarata e projektuesit të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik

të lejeve të ndërtimit,

- Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet,
- Preventivi Përfundimtar.
- Afati i realizimit të punimeve të projektit.

### **Rekomandime për projektuesin**

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me “Perroin e Bardhe”. Projektuesi duhet të hartojë përveç projektit përfundimtar dhe një projekt teknik, i cili duhet të analizojë rast pas rasti të gjitha prishjet e mundëshme për të realizuar me faza këte investim.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia Permet, seksioni i Urbanistikës dhe nga Kadastra. Në hartimin e projektit duhet të kihet parasysh edhe standarte të ndryshme që ka nxjerrë Bashkia Permet .
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar

### **Hidrologjia**

Të bëhet studimi hidrologjik për të përcaktuar hidromodulin e zonës në studim. Analizat dhe llogaritjet e reshjeve në zonë. Llogaritjet e shkarkimit maksimal të ujërave.

### **Paraqitja e vizatimeve:**

*Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimum fletët si më poshtë:*

1. Topografinë e gjëndjes ekzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha situatat në gjëndjen e sotme të kanalit në Shk. 1:500 ose 1:1000
2. Planimetria e sistemit të kanalit në Shk. 1:500 ose 1:1000
3. Planimetria e prishjeve të rrugës në shkallë 1:500
4. Profili gjatësor i kanalit Shk. 1:1000, 1:100.
5. Profilat tërthorë të kanalit jo më pak se 25 m
6. Detaje konstruktive tip të shtresave të kanalit, pritave, pusëve, etj.
7. Pusëta dhe detaje të seksionit tip të kanalit

### **Materiale referuese (temat e referencës):**

- Detyra e projektimit.
- Planimetri të gjëndjes ekzistuese.
- Vizite e detyruar në objekt.
- Të paraqitet Gen-plani i përgjithshëm dhe Gen-plani i fragmentuar i vendodhjes së objektit..
- Të paraqiten detaje (hollësi) të ndryshme arkitekturore dhe ndërtimore..
- Të gjitha fletët e projekteve të arkitekturës të jenë saktësisht të dimensionuara, të kuotuar, me akset në të dy drejtimet, dhe saktësisht të dallueshme dhe lexueshme..
- “Specifikimeve të përgjithshme për punimet e ndërtimit” K.T.Z. si dhe paraqitjen e albumit të “Shënimeve të veçanta të objektit”..
- E gjithë metodologjia e projektimit do të bazohet referuar Kushteve Teknike të Projektimit (K.T.P), dhe Kushteve Teknike të Zbatimit (K.T.Z.), standarteve shtetërore në Rep. e Shqipërisë, pa përjashtuar dhe standartet e CE.

## GJURMA E OBJEKTIT



Gjurma ekzistuese perroi i bardhe L=2 km





### **Elemente te mbetur te mbrojtjes se dikureshme e perroit te bardhe**

*Mbrojtja e dikureshme e ujrave te larta te kanalit perroi i bardhe eshte realizuar rreth viteve 1965 e cila ishte e realizuar me prita me mure gabion me qellim depozitim e inerteve qe vijne nga vershimi i ujrave si dhe shtresa betoni me qellim levizjen e ujrave ne menyre te kontrolluar drejt kanalit te betonit sipas seksionit tip.*

*Aktualisht keto prita jane te shkaterruara si rezultat i erozionit si dhe demtimit te mureve te gabionit nga persona te pa autorizuar apo te papergjegjshem.*





**Zona ku duhet te nderhyet ne infrastrukturen e kanalit**

*Zona-1 ndertimi i pritave dhe shtreses betonit , Zona-2 eshte me seksion tip kanali me beton i ndertuar, Zona-3 ndertimi seksionit tip te kanalit me beton i mbuluar.*



**ZONA-1 Zona ku duhet te ndertohen pritat dhe shtresat e betonit**

*Ne kete zone grumbullohen ne kanal nga rrjedhjet e perrenjeve dhe rrekeve qe vijne nga mali i Dhembelit. Se bashku me ujrart te cilat vershohen ne sasi te konsiderueshme ato sjellin edhe aluvione te lojeve te cakellit, gureve te medhenj, dhera e peme te shkuluara te silat vazhdojne rrjedhen ne drejtim te qytetit.*





**ZONA-3 ku duhet te ndertohet seksioni tip i kanalit me beton i mbuluar**

*Sic shihet kanali ne kete seksion kalon ne nje zone me infrastrukture urbane te ndertuar me objekte private dhe kalon pothuajese ne zonen qendrore te qytetit.*



**FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE**





